



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
KABINETI

Nr. 17804/2 Prot.

Tiranë, më 14.01 2013

URDHER

Nr. 1, Datë 14.01.2013

Për

**shpalljen e disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2012 në disa standarde
ndërkombëtare të raportimit Financiar (SNRF)**

Në mbështetje të nenit nr. 4, pika 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, i ndryshuar, të VKM nr. 672, datë 26.10.2005 "Për miratimin e rregullores së brendëshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe sipas Vendimit nr. 3, datë 24.10.2012 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

URDHEROJ:

- Shpalljen për zbatim të disa ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit 2012 në disa standarde ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe të përkthyer në shqip nga gjuha angleze nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë:
 - Ndryshime në Standardet të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 10, nr. 11, nr. 12
 - Ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 1, Huatë qeveritare.
 - Ndryshime në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) nr. 1, Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve.Tekstet e të cilëve janë bashkëlidhur këtij Urdhëri dhe janë pjesë integrale e tij.
- Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar", i ndryshuar, janë të detyruara të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, të aplikojnë ndryshimet si në pikën 1 të këtij Urdhëri, duke filluar nga muaji janar 2013.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Ridvan BODE

MINISTER

